



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVA



KOMUNA E PEJËS MUNICIPALITY OF PEJA OPŠTINA PEĆ

KUVENDI I KOMUNËS SË PEJËS

I.Numër: 463/01/40972 dt. 29 Qershor 2026

Në bazë të nenit 11, nenit 12 par.2 pika d, nenit 14 par.1 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-40 të datës 20 shkurt 2008 të neneve 5,6,8 dhe 14 të Ligjit nr. 06/L-092 mbi dhënien në shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme Komunës, neni 4, neni 5 paragrafi 1.2, neni 6 dhe nenit 8 të Rregullores (QRK) Nr.09/2020 për përcaktimin e Procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës si dhe nenit 20 paragrafi 1 pika 1.4 të Statutit Nr.01/2020 të Komunës së Pejës, I. Numër: 01-016/01-413431.dt.30. shtator 2020, Vendimit Nr. 08/2026 mbi miratimin e listës së veçantë të pronave Komunale të Komunës së Pejës që do të jepen në shfrytëzim gjatë vitit 2026, me numër protokolli 400/01-8274 të datës 26 Shkurt 2026, pasi shqyrtoj propozimin e Kryetarit të Komunës për miratimin paraprak për dhënien në shfrytëzim të parcelës komunale – përkatësisht të 2 (dy) sporteleve komunale - *Parcela Komunale, e që të dyja në sipërfaqe prej 5.55m² të destinuara për ofrimin e aktiviteteve shërbyese financiare*, Kuvendi Komunal Pejë, në takimin e mbajtur me date: dt. 29 Qershor 2026, nxjerr këtë:

VENDIM

Nr. 71-2026

Mbi miratimin paraprak për dhënie në shfrytëzim të pronës së paluajtshme komunale - Parcela Komunale, përkatësisht 2 (dy sportele) të objektit të komunës në sipërfaqen e njëjtë prej 5.55m² ZK Pejë me qëllim të ofrimit të aktiviteteve shërbyese financiare

- I. **Miratohet** propozimi i Kryetarit të Komunës miratimin paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të 2 (dy) sporteleve komunale - Parcela Komunale, e që të dyja në sipërfaqe prej 5.55m² të destinuara për ofrimin e aktiviteteve shërbyese financiare pronë Komuna Pejë të cilat janë të destinuara për qiradhënie në afat prej pesë (5) vite, sipas Vendimit Nr.08/2026 mbi miratimin e listës së veçantë të pronave Komunale të Komunës së Pejës që do të jepen në shfrytëzim gjatë vitit 2026, me numër protokolli 400/01-8274, dt. 26 Shkurt 2026.

Nr.	PRONARI Poseduesi	Nr. i Ngastrës	Emri i rrugës (lokacioni)	Sipërfaqja	Zona Kadastrale	Destinimi	Periudha
1.	Komuna Pejë		Rruga “ Hasan Prishtina” Objekti i Komunës.	I. 5.55m ² II. 5.55m ²	ZK Pejë	Për ofrimin e aktiviteteve shërbyese financiare	5 vite

- II. Dhënia në shfrytëzim afatshkurtër e pronës së paluajtshme të komunës nga një (1) deri në pesëmbëdhjetë (15) vite bëhet përmes procedurës së ankandit publik.

- III. Pas plotësimit të kushteve ligjore komisioni për komunal për vlerësimin e ofertave do të inicioj procedurën e ankandit publik, për zgjedhjen e ofertës më të favorshme për dhënie në shfrytëzim afatshkurtër të 2 (dy) sporteleve komunale ZK Pejë që të dyja në sipërfaqe me nga 5.55m² të destinuara për qiradhënie në afat prej pesë (5) vite.
- IV. Për zbatimin e këtij Vendimi dhe dispozitave të ligjit për dhënie në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, obligohet që të kujdeset Komisioni Vlerësues, Drejtoria për Çështje Pronësore-Juridike.
- V. Ky vendim hynë në fuqi 30 (tridhjetë) ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale, si dhe 7 (shtatë) pas publikimit në web- faqen e Komunës së Pejës.

Vendimi ti dërgohet:

MAPL-së,
Kryetarit të Komunës,
DÇPJ,
Arkiv.



KRYESUESI I KUVENDIT
Z. Rexhep Kurtbogaj